



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 4 Shkurt 2022

Nr: 45

VENDIM

PËR

**CAKTIMIN E VENDEVE TË NUMËRIMIT TË VOTAVE TË ZAZ NR. 2, NR. 3, NR. 4,
NR. 5, NR. 19, NR. 21, NR. 22, NR. 23, NR. 24, NR. 26, NR. 43, NR. 54, NR. 55, PËR
ZGJEDHJET E PJESSHME VENDORE PËR KRYETAR BASHKIE TË DATËS 6 MARS
2022**

Në mbështetje të Dekretit të Presidentit të Republikës nr. 13438, datë 20.01.2022 “Për caktimin e datës së zgjedhjeve të pjesshme vendore për kryetar bashkie për disa njësi të qeverisjes vendore”, të neneve 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, 93, pika 1 dhe 94, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V Ë R E N:

Referuar nenit 94, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, jo më vonë se 60 ditë para datës së zgjedhjeve, prefekti i qarkut i paraqet KQZ-së listën e plotë të objekteve brenda territorit të qarkut, që përmbushin kushtet për caktimin e Vendit të Numërimit të Votave, sipas përcaktimeve në nenin 93 dhe 94 të Kodit Zgjedhor.

Komisioni Rregullator, me vendimin nr. 2, datë 22.01.2022, “Për miratimin e disa afateve procedurale që lidhen me zgjedhjet e pjesshme për kryetar në bashkitë Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnjë, që do të zhvillohen më datë 6 Mars 2022”, ka miratuar afatet proceduriale që do të zbatohen për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022. Në pikën 14 të këtij vendimi referohet se, brenda datës 27 Janar 2022, prefektet e qarqeve Shkodër, Durrës, Dibër, Tiranë dhe Fier duhet të paraqesin në KQZ listën e plotë të objekteve brenda territorit të Qarkut që përmbushin kushtet e parashikuara në ligj për Vendin e Numërimit të Votave.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me shkresat nr. 142-151 prot., datë 24.01.2021, u është drejtuar prefektëve të qarqeve Shkodër, Dibër, Durrës, Tiranë dhe Fier për të vënë në dispozicion listën e

plotë të objekteve brenda territorit të qarkut, për caktimin e Vendit të Numërimit të Votave, të cilët përmbushin kriteret e parashikuara në Kodin Zgjedhor dhe në vendimin nr. 3, datë 9.2.2021, të Komisionit Rregullator, “Për kriteret e caktimit dhe organizimit të Vendit të Numërimit të Votave”.

Prefektët e qarqeve Shkodër, Dibër, Durrës, Tiranë dhe Fier kanë paraqitur në KQZ listën e objekteve brenda territorit të qarkut përkatës. Nga shqyrtimi i të dhënave të objekteve të paraqitura rezulton se, objektet dhe mjediset përkatëse plotësojnë kriteret e parashikuara në nenin 93 dhe 94 të Kodit Zgjedhor, si dhe kriteret teknike të përcaktuara në vendimin nr. 3, datë 9.02.2021, të Komisionit Rregullator, “Për kriteret e caktimit dhe organizimit të Vendit të Numërimit të Votave”.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, 93 dhe 94 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në nenet 4 e 5, të vendimit nr. 3, datë 9.2.2021, të Komisionit Rregullator, “Për kriteret e caktimit dhe organizimit të Vendit të Numërimit të Votave”,

V E N D O S I:

1. Të caktojë Vendet e Numërimit të Votave të ZAZ nr. 2, nr. 3, nr. 4, nr. 5, nr. 19, nr. 21, nr. 22, nr. 23, nr. 24, nr. 26, nr. 43, nr.54 dhe nr. 55, sipas lidhjes që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 24 (njëzet e katër) orëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



Qarku	KZAZ	Nr. QV	Nr.Tav/ Vendimi	Objekti i propozuar për VNV	Sipërfaqja
Shkodër	02	109 QV	7	Pallati i Sportit "Qazim Dervishi"	650 m2
	03	48 QV	4	Shkolla e mesme "Shenjaze Juka", palestra	200 m2
	04	46 QV	4	Shkolla 9-vjeçare "Ismail Qemali", palestra	350 m2
	05	47 QV	4	Shkolla 9-vjeçare "Edit Durham", palestra	360m2
Dibër	19	101 QV	7	Shkolla e mesme "Nazmi Rushiti", palestra	300 m2
Durrës	21	108 QV	7	Pallati i Sportit "Ramazan Njala"	mbi 300 m2
	22	79 QV	6	Shkolla 9-vjeçare "Marie Kaçulini", palestra	mbi 250 m2
	23	75 QV	5	Shkolla e muzikës "Jan Kukuzeli", palestra	mbi 250 m2
	24	73 QV	5	Shkolla e mesme "Leonik Tomeo", palestra	mbi 250 m2
Tiranë	26	44 QV	4	Shkolla 9-vjeçare Marqinet 2, Palestra	530 m2
	43	53 QV	5	Gjimnazi "Haxhi Qehaj", palestra	420 m2
Fier	54	92 QV	6	Shkolla 9-vjeçare "Skënder Libohova", palestra	504m2
	55	65 QV	5	Holli i Muzeut Historik, Lushnjë	200 m2

